

VENDIM
Nr. 605, datë 5.9.2012

**PËR PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE MËNYRËN E PAGESËS SË DETYRIMIT FINANCIAR
NË RASTET E PAVLEFSHMËRISË SË PJESSHME TË AMTP-VE, SI REZULTAT I
MOSRESPEKTIMIT TË NORMËS PËR FRYMË TË TOKËS BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, paragrafi 4 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rastet kur pavlefshmëria e pjesshme e krijimit të aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) vjen për shkak të mosrespektimit të normës për frymë të fshatit dhe toka bujqësore është ende në emër të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, përpara marrjes së vendimit për pavlefshmëri të pjesshme, komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) njofton mbajtësin e titullit të pronësisë për rezultatin e konstatimit dhe mundësitë ligjore që ofrohen për zgjidhjen e tij.

Njoftimi përmban:

a) Sipërfaqen e tokës bujqësore që subjekti ka përfutur në fakt, sipas AMTP-së.
b) Arsyetimin dhe llogaritjen e sipërfaqes së tokës bujqësore që i përket subjektit përfutur, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, dhe me aktet e tjera, në zbatim të tij.

c) Sipërfaqen shtesë të tokës bujqësore që subjekti ka përfutur, mbi sipërfaqen që i përket në bazë të ligjit.

ç) Propozimin, sipas të cilit subjekti mund të bëhet pronar, kundrejt pagesës, i një sipërfaqeje deri në 10 për qind të sipërfaqes së llogaritur sipas shkronjës “b”, por jo më shumë se sipërfaqja e llogaritur sipas shkronjës “c”.

d) Pasqyrimin hartografik të sipërfaqeve për të gjitha rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të kësaj pike.

dh) Afatin kohor brenda të cilit subjekti përfutur duhet të paraqitet në komisionin vendor (KV).

e) Pasojat që vijnë si rezultat i mosparaqitjes në komisionin vendor (KV) në afatin e përcaktuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, apo i refuzimit të propozimit, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi.

2. Subjekti përfutur, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, duhet të deklarojë me shkrim pranë komisionit vendor (KV) nëse pranon propozimin sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij vendimi. Komisioni vendor (KV) mban procesverbal, ku evidentohet ky fakt. Në rast se subjekti përfutur nuk paraqitet pranë komisionit vendor (KV) sipas afatit të përcaktuar, atëherë KV-ja, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga marrja e njoftimit prej subjektit përfutur sipas pikës 1, merr vendim për pavlefshmëri të pjesshme të AMTP-së, për sipërfaqen e tokës bujqësore, të llogaritur sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe ndjek procedurat e përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar.

3. Në rast se subjekti përfutur deklaron se nuk pranon të blejë sipërfaqen e tokës bujqësore të ofruar, komisioni vendor (KV), brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga marrja e njoftimit prej subjektit përfutur sipas pikës 1, merr vendim për pavlefshmëri të pjesshme të AMTP-së, për sipërfaqen e tokës bujqësore, të llogaritur sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe ndjek procedurat e përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar.

4. Në rast se subjekti përfutur pranon të blejë sipërfaqen e ofruar të tokës bujqësore, komisioni vendor (KV) i njofton atij:

a) vlerën e pagesës së sipërfaqes të tokës bujqësore që i ofrohet për ta blerë, e cila llogaritet sipas hartës së vlerës të tokës së AKKP-së, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) se vlera e pagesës së sipërfaqes së tokës bujqësore, që i ofrohet për ta blerë, të derdhet në vlerë të plotë, në bankat e nivelit të dytë, në llogarinë e Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të degës përkatëse të thesarit;

c) se afati i kryerjes së pagesës dhe paraqitja e mandatit të pagesës në komisionin vendor duhet të

kryhet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga marrja e njoftimit prej subjektit përfitues sipas pikës 1 të këtij vendimi.

5. Komisioni vendor (KV), gjatë kryerjes së njoftimeve, sipas pikave 1 dhe 4 të këtij vendimi, respekton procedurat e njoftimit, të përcaktuara në nenin 60 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

6. Në rastet kur subjekti përfitues kryen pagesën dhe e depoziton mandatpagesën në KV, atëherë komisioni vendor, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit prej subjektit përfitues, sipas pikës 1 të këtij vendimi, merr vendim për ligjërimin e sipërfaqes shtesë të tokës bujqësore dhe për korrigjimin e AMTP-së. Komisioni vendor (KV) përgatit AMTP-në sipas modelit të përcaktuar në vendimit nr. 229, datë 19.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e krijimit të AMTP-ve si pasojë e korrigjimeve të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë”.

Vendimi i komisionit vendor dërgohet për dijeni në DAMT, pranë këshillit të qarkut dhe në ZVRPP. Sekretariati teknik pranë Komisionit Qeveritar të Tokës e depoziton një kopje të vendimit të komisionit vendor (KV) në Agjencinë e Kthimit e Kompensimit të Pronës.

7. Në rast se pas realizimit të kërkesave të pikës 5 të këtij vendimi, rezulton ende sipërfaqe e tepërt, atëherë komisioni vendor (KV), brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit prej subjektit përfitues sipas pikës 1 të këtij vendimi, merr vendim për pavlefshmëri për sipërfaqen e mbetur të tokës bujqësore, të paligjëruar, dhe ndjek procedurat e përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar.

8. Ngarkohen Komisioni Qeveritar i Tokës, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha